



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 84-të të mbajtur më 30.03.2023 ka miratuar sa vijon

VENDIM

Denoncimi l regjistruar sipas numrit 12-3619/1 të datës 29.09.2021, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-3619/1 të datës 29.09.2021 të mbyllet dhe të arkivohet

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 29.09.2021, është dorëzuar denoncim për angazhimi të mekanizimit nga ana e Komunës ----- dhe është formuar lënda me numër 12-3619/1 të datës 29.09.2021.

Në denoncim thuhet se komuna merr me qira makineri edhe pse e ka në pronësi për arsye të ndryshme. Në vijim jepet shembull se personi juridik -----
- - për të njëjtin pronar të një kompanie tjetër, kryetari i mëparshëm ka bërë blerjen e një ekskavatori me vlerë prej 30 mijë euro dhe thuhet se historia po përsëritet dhe kërkohet nga KSHPK-ja që të hetojë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka pretendime apo paligjshmëri konkrete që tregojnë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga zyrtarët, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:

- parashtruesi i denoncimit

Përpilo: B.K.SH.

Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Nënkryetar
Katica Nikolovska

